



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2213 Prot

Peshkopi, më 22.06.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.49

Data 16.06.2022

“Për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë
Dibër për financimin e projektit “Tungjatjeta Jetë” për 4 punonjës”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Në mungesë dhe porosi

Punonjësja e Sekretariatit të Këshillit

P/Sara Karaj





22/13/A
23/06/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR


Nr.576/1.prot. Peshkopi, më 23.06.2022

Lënda : Per vendimin nr. 49, datë 16.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër
Drejtuar : BASHKISË DIBËR

P E S H K O P I

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.49, date 16.06.2022 “Për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit “Tungjatjeta jetë” për 4 punonjës”, vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacioni aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to, veprime që kuroherë janë përgjegjësi direkte administrativo- ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraguesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 49 Date 16/06/2022

“Për përdorimin e fondit nga transfertat e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit “Tungjatjeta Jetë” për 4 punonjës”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.54/1 prot. datë 21.01.2022.Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Dibër”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16.06.2022 me 18 vota pro, 2 kundër dhe 0 apstenim


VENDOSI:

- I. Miratimin në bazë të vijimësisë së marrëveshjes së bashkëpunimit për financimin e projektit “Tungjatjeta Jetë” midis Bashkisë Dibër dhe projektit “Tungjatjeta Jetë” World Vision këtij projekt-propozimi ti shtohet buxheti të Bashkisë Dibër, me kontribut të World Vision 1.480.000 lekë dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Dibër me vlerë 849.443 lekë.
- II. Përfshirjen e 4 punonjësve si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.
- III. Kjo marrëveshje është 8 mujore dhe pagesa do llogaritet që në muajin Qershor 2022 Ndryshimet janë bërë në buxhejin e vitit 2022.
- IV. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

Adresa: Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822937

- V. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

Kryetar Këshilli



Adresa: | Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822937



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHETTESE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 Date 26/05/2022

“Për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit Tungjatjeta Jete për 4 punonjës”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022 vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.54/1 prot. datë 21.01.2022.Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Dibër”

Kërkesime:

- I. Në bazë të vijimitesë së marrëveshjes së bashkëpunimit për financimin e projektit “Tungjatjeta Jete” midis Bashkisë Dibër dhe projektit “Tungjatjeta Jete” World Vision kërkojmë miratimin e këtij projekt-propozimi ti shtohet buxheti të Bashkisë Dibër, me kontribut të World Vision 1.480.000 lekë dhe bashkëfinancimin e Bashkisë Dibër me vlerë 849,443 lekë.
- II. Përfshirjen e 4 punonjësve si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.
- III. Kjo marrëveshje është 8 muajore dhe pagesa do llogaritet që në muajin Maj 2022 me personelin aktual të marrëveshjes së mëparshme. Ndryshimet janë bërë në buxhetin e vitit 2022.
- IV. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër
- V. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala




Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Elona Lusha



Drejtori Ekonomik

Lorenc Cibaku



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTTETËSE

RELACION

{Me të dhëna të grupuara, për përdorimin e fondit nga transferata e World Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibër për financimin e projektit “Tungjatjeta Jete” për 4 punonjës}

KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” pika “dh”, citohet “ miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë; duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër. Institucioneve në varësi dhe Njërive Administrative për vitin 2022 vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.54/1 prot. datë 21.01.2022.”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Dibër”

Kërkojme nga ana juaj miratimin e këtij projekt-propozimi ti shtohet buxheti të Bashkisë Dibër, me kontribut të Eorld Vision 1.480.000 (Një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë lekë) dhe bashkë financimin e Bashkisë Dibër me vlerë 849,443 (Tetëqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet e tre lekë). Përfshihen e 4 punonjësve si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibër.

Projekti “Tungjatjeta Jete” ka 4 vite që ka nisur shërbimin në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara në zona të thella të dibrës. Ky projekt ka për qëllim mbështetjen Psiko-Sociale dhe Terapiive për fëmijët me aftësi të kufizuara në Dibër duke ofruar shërbim në shtëpi nga njësia e Shërbimit Lëvizës.

Tungjatjeta Jete është një bashkëveprim i veprimeve në shtëpi, gendrat e specializuara dhe Shkolla. Njësia përbëhet nga një menaxher, një ekip profesionitësh në përberje të të cillit janë :

1. Një psikologë
2. Një fizioterapist
3. Një Logoped
4. Një shofer

Të cilët kanë aftësi dhe mjete të nevojshme për zhvillimin e terapisë në shtëpi. Njësia e Shërbimit është pajisur me infrastrukturë të nevojshme (automjete, materiale pune)për të ofruar shërbime cilësore për fëmijët më aftësi të kufizuara në familje .

Njësia lëvizëse ofron shërbim për 36 fëmijë më aftësi të kufizuara në zona të thella të Bashkisë Dibrë nëpër shtëpi.

Kjo marrëveshje është 8 mujore dhe pagesa do llogaritet që në muajin Maj 2022 me personelin aktual të marrëveshjes së mëparshme. Ndryshimet janë bërë në buxhetin e vitit 2022.

Buxheti total i Projektit:

Buxheti Total i Projektit	2.329.443
Kontributi total i Bashkisë Dibrë	849.443
Kontributi i World Vizion Albania	1.480.000

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe vazhdimi e ofrimit të shërbimit për fëmijët me aftësi të kufizuara kërkojme nga ana juaj miratimin e Projek-Vendimit

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për përdorimin e fondit nga transferta e world Vision dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Dibrë për financimin e projektit “Tungjatjeta Jete” për 4 punonjës dhe përfshirjen e tyre si pjesë e Strukturës së Bashkisë Dibrë.

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora LALA





Nr. 1788 Prot.
Dt. 25/05/2022

WORLD VISION

Nr. 33 Prot.
Dt. 01/05/2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

inancimin e Projektit "Tungjatjeta Jetë"

Për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për fëmijët dhe të rinj me aftësi të kufizuara në Bashkinë Dibër nga profesionist, përmes modelit "Tungjatjeta...Jetë".

Nr. Marrëveshjes:

4 (Katër)

Titulli i projektit:

"Tungjatjeta... Jetë"

Institucioni zbatues:

Bashkia Dibër

Periudha e Bashkëpunimit:

8 muaj (1 maj 2022 - 31 dhjetor 2022)

Buxheti Total i Projektit:

2.329.443 Lekë
(Dy milion e treqind e njëzet nëntë mijë e katërqind e dyzet e tre lekë)

Kontributi i Bashkisë Dibër:

849.443 Lekë
(Tetëqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet e tre lekë)

Kontributi i World Vision Albania:

1.480.000 Lekë
(Një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë lekë)


Elidhur sot në datë **11/04/2022**, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kodit Civil të RSH dhe Ligjit nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara", ndërmjet:

World Vision Albania, një organizatë ndërkombëtare joqeveritare, me regjistrim gjykatë 2544 më 09/09/1999, NIPT J92127018B, me zyrën e saj shqiptare të vendosur në Rr. "Skenderbej", Kompleksi "Gurten", Kati 2, Tiranë, dhe adresë postare: Kutia Postare 1725, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtor Ekzekutiv Znj. Eljona Elmazi.

DHE

Bashkisë Dibër, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Rahim Spahiu ;

Për këto arsye, Bashkia Dibër dhe World Vision Albania ranë dakord të bashkëpunojnë për realizimin e projektit: "Tungjatjeta Jetë" për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, për periudhën 01/05/2022-30/12/2022.





Njësia lëvizëse përbëhet nga një menaxher , një ekip profesionistësh në përbërjen e të cilit janë: një punonjës socialë; një psikologë; një fizioterapist ; një logoped, të cilët kanë aftësi dhe materiale të nevojshme për zhvillimin e terapisë në shtëpi . Njësia e shërbimit lëvizës është pajisur me infrastrukturë të nevojshme (automjet, materiale pune) për të ofruar shërbime cilësore për fëmijet me aftësi të kufizuara në familje.

Ky program do të adresojë numrin e madh të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Dibër dhe mungesës së shërbimeve komunitare të specializuara, për ti ndihmuar ata të jetojnë në potencialin e tyre të plotë.

Njësia lëvizëse do të ofrojë shërbim 36 fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Dibër ,një herë në javë në shtëpi. Shërbimi fillon me vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe familjes nga ekipi, vlerësim i cili bazohet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionalitetit (KNF). Ekipi do të vlerësojë nevojat e fëmijës dhe familjes dhe do të zhvillojë një Plan Zhvillimi Individual (PZH) dhe do të kryejë vizita/terapi në familje sipas planit të përcaktuar në PZH. Ky ekip specialistësh në të njëjtën kohë do të mbështesë anëtarët e familjes / kujdestarët/mësuësit duke synuar aftësimin e tyre në realizimin e aktiviteteve që ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e tyre.

Ky ekip do të menaxhohet teknisht nga menaxheri i programit “Tungjatjeta ...Jetë” nga një staf i World Vision Albania, i cili siguron mbarevatjen dhe zbatimin cilësor të këtij programi.

Modeli i ndërhyrjes “Tungjatjeta... Jetë” ka pesë vite që ka nisur shërbimin në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara duke e shtrirë shërbimin e tij vit pas viti në zonat më të thella të Librazhdit, Prrenjasit, Dibërës, Bulqizës, Lezhës dhe Rrogzohinës.

“Tungjatjeta...Jetë” një model inovator në kushtet e pandemisë Covid_19 solli risi në ofrimin e ushtrime këshillave online bazuar në Planin e Zhvillimit Individual.

Objektivat e projektit janë si më poshtë:

- 36 fëmijë me aftësi të kufizuara përfitojnë rregullisht nga shërbimet mbështetëse kognitive, psikosociale dhe terapeutike nga Shërbimi Lëvizës Komunitar “Tungjatjeta..Jetë”, duke iu dhënë atyre një shans për të realizuar potencialin e tyre të plotë.

- Shërbimi Lëvizës Komunitar “Tungjatjeta..Jetë”, është funksionale me aftësi dhe infrastrukturë të nevojshme për të ofruar shërbime cilësore për fëmijet me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në mjedisin e tyre familjar.

Neni 3: Deklarime dhe garanci reciproke

1. Kjo marrëveshje bazohet në vizionet e përbashkëta të World Vision Albania dhe Bashkisë Dibër, që “Fëmijet dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të përfitojnë përkudjesjen maksimale nëpërmjet marrjes së shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake dhe detyrimit që ka pushteti vendor ndaj shërbimeve për mirëqenjen e fëmijëve, sipas pikës 10 të Udhëzimit nr.597, date 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuara”.
2. World Vision Albania dhe Bashkia Dibër pranojnë se kjo Marrëveshje do të bazohet në parimet e zhvillimit të komunitetit dhe përshirjes sociale dhe do të nxitet prej tyre. Ata përkushtohen që të krijojnë vullnet të mirë, besim dhe mirëkuptim reciprok në çdo rast të mundshëm, si dhe të identifikojnë, dokumentojnë dhe zbatojnë praktika të mira partneriteti për të siguruar suksesin e projekteve të partneritetit.
3. World Vision Albania dhe Bashkia Dibër bien dakord që do të kontribuojnë, gjatë zbatimit të projektit duke siguruar ndryshime pozitive, afatgjata dhe të qëndrueshme në jetën e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në zonën e Dibërës.
4. Secilia Palë do të ketë personalisht përgjegjësinë për t'u përpatur me legjislacionin ose rregullat në fuqi kur të kryejë punë dhe veprimtari të tjera nën këtë Marrëveshje dhe nën çdo akt ligjor apo nënligjor të zbatueshëm ndaj secilës Palë.





8. Bashkia Dibër të koordinojë punën mes stafit të projektit dhe stafit në qendrën ditore. Nën ombrellën e këtij koordinimi, rolet dhe përgjegjësitë e ekipit të "Tungjatjeta...Jetë", nuk do të jetërsohen në funksion të qendrës ditore
9. Bashkia Dibër duhet të ndjekë procesin e rekrutimit (nëse është e nevojshme) në përputhje me modalitetet e paracaktuara në bashkëpunim me World Vision Albania.
10. Bashkia Dibër duhet të respektojë marrëveshjet me punëdhënësit në përputhje me modalitetet e paracaktuara në bashkëpunim me World Vision Albania Bashkia Dibër duhet të sigurojë të njëjtën mbështetje nga ana e procedurave të brëndshme, detyrimeve për pushimet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar si çdo staf tjetër i këtij institucioni, por pa ndërhyrë në përshtirimin e punës në përputhje me modalitetet e paracaktuara në bashkëpunim me World Vision Albania.
11. Bashkia Dibër dakordësohet me World Vision Albania mbi vendin dhe format e dokumentimit të shërbimit lëvizës.
12. Bashkia Dibër ka përgjegjësinë të informojë World Vision Albania rreth programit dhe ecurisë së tij, së bashku me raportin financiar. Raporti i fundit narrativ dhe databaza e përfutësve, dërgohet tek World Vision Albania, në fund të dhjetorit 2022.

Neni 6: Kushti i Transferimit të Fondeve



1. Transferimi i fondeve sipas kësaj Marrëveshje kryhet me kusht në kuptim të nenit 768 të Kodit Civil. Kushti i transferimit lidhet me përdorimin ekskluziv të Fondit vetëm për pagesat e specialistëve dhe shoferit me kohë të plotë për periudhën Maj 2022 deri në Shtator 2022, për fëmijë e të rinj me Aftësi të Kufizuar përmes modelit "Tungjatjeta...Jetë", "Kushti".
2. Me qëllim vërtetimin e realizimit të "Kushtit"
 - 2.1 Fondi do të transferohet tek Bashkia në formë e një Kestëve, në formë parafinancimi, në bazë të Udhëzimeve të Partneritetit Financiar të World Vision Albania.
 - 2.1.1. Kësti i parë: 1.000.000 lekë, në maj 2022 në formë parafinancimi.
 - 2.2 Në qershor 2022, tetor 2022 Bashkia Dibër do të paraqesë World Vision Albania informacion në lidhje me pagesat e stafit të shërbimit lëvizës sipas ligjit të punësimit, mbi shpenzimin e fondit të kaluar nga World Vision Albania
 - 2.3 Dokumentat të vlefshme që vërtetojnë pagesat e stafit të shërbimit lëvizës tek World Vision Albania janë bordero; pagesa e sigurimeve; transferata bankare që vërteton pagesën e stafit, kjo referuar ligjit shqiptar.
 - 2.4 Nëse Bashkia Dibër nuk plotëson "Kushtin" deri në fund të kësaj marrëveshje për arsye të ndryshme, fondi i transferuar në Bashkinë Dibër me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.
 - 2.5 Nëse ndonjë nga stafi i shërbimit lëvizës nuk plotësojnë kushtet sipas marrëveshjes së punës apo jep dorëheqjen për arsye të ndryshme fondi i transferuar në Bashkinë Dibër me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.
 - 2.6 Bashkia Dibër duhet të paraqesë mandat arkëtimi nga dega e thesarit për çdo trasfertë të kryer për këtë "Kusht".
 - 2.7 Nëse projekti dështon për arsye madhore të cilat çojnë në prishje të marrëveshjes, fondi i transferuar në degen e thesarit të Bashkisë Dibër me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.
3. Fondi do të transferohet në llogarinë e mëposhtme bankare të Bashkisë:

BKT, Dega Dibër: AL27205582062796450LTHESALLA

Dega e thesarit: Bashkia Dibër

Kodi i pagesës: 2106001

4. Komisionet bankare do të mbulohen nga World Vision Albania.





dhënë të palë të treta, çdo lloj informacioni dokumenti apo të dhënë, për shkak të kërkesave të ligjit, do të kërkohet miratimi paraprak me shkrim i përfaqësuesve respektiv të secilës Palë.

Neni 12: Ligjet e zbatueshme dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje u nënshtrohet ligjeve të Shqipërisë. Mosmarrëveshjet që, sipas mendimit të njëjës prej palëve, nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme, mund t'i kalojnë gjykatës kompetente.
2. Kjo marrëveshje rishikohet ose ndërpritet: - në kushtet e situatave emergjente; - në tërmete; - në situata pandemike apo të luftës që vendi mund të kalojë, në dakortësinë e palëve, nëse do t'i zgjidhin në mënyrë miqësore, në të kundërt do të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 13: Aneksat

Bashkallidhen si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Marrëveshje, dokumentat si më poshtë :


- Aneksi Nr. 1: Plani i punës.
- Aneksi Nr. 2: Buxheti

Bashkia Dibër

Kryetari i Bashkisë

Rakim Spahiu

Data:



World Vision Albania

Drejtor Ekzekutiv

Eljona Elmazi

Data:



BUXHETI I TOTAL I PROJEKTTIT NË LEKË

Emri i Partnerit: Bashkia Diber

Emërtimi i Projektit: "Tungjatjeta Jete"

Kohëzgjatja e projektit: 8 muaj (maj 2022 - dhjetor 2022)

Vendi: Bashkia Diber

Buxheti total i Projektit: 2,329,443

Kontributi i Bashkia Diber: 849,443

Kontributi i World Vision Albania: 1,480,000

Nr	Aktiviteti	Njesia	Muaj/Jave /Dite	Sasia	Kosto për njesi / Lek	Kosto Total /lek	Kontributi i Bashkise Diber	Kontributi i World Vision Albania
1	Burimet njerëzore				211,180	1,689,443	689,443	1,000,000
1.3	Psikolog	punonjës	8	1	57,696	461,572	173,089	288,482
1.4	Fizioterapist	punonjës	8	1	57,696	461,572	173,089	288,482
1.6	Logopedist	punonjës	8	1	57,696	461,572	173,089	288,482
1.8	Shoferi	punonjës	8	1	38,091	304,727	114,273	190,454
2	Trajnim & mentorin stafi		8		10,000	35,000	0	35,000
2.1	Trajnim	session	1	1	5,000	5,000	0	5,000
2.2	Mentorim	session	6	1	5,000	30,000	0	30,000
3	Mbështetje per femijet dhe familjet				5,000	150,000	0	150,000
3.1	Paketa ushqimore /higjienike per familjaret e femijëve	paketa			5,000.0	150,000.0	0.0	150,000.0
4	Vizibilitet		3	10	5,000.0	15,000.0	0.0	15,000.0
4.2	Vedio	Vedio	1	1	15,000.0	15,000.0	0.0	15,000.0
5	Mirëmbajtje makine, qera, drita, uje, internet per Qendren komunitare dhe zyrtare stafi				55,000	440,000	160,000	280,000
5.1	Mirëmbajtje makine & Nafte	Mirëmbajtje makine & Nafte	8	1	35,000	280,000	0	280,000
5.2	Drita uje internet	Drita&ujë	8	1	15,000	120,000	120,000	0
5.3	Detergjent per pasttrimin	Detergjent	8	1	5,000	40,000	40,000	0
				Buxhet Total	296,180	2,329,443	849,443	1,480,000
						Kontributi ne %	36.47%	63.53%

Shënime: Kontributi i World Vision Albania përbehët prej 1,000,000 ALL në transferim fondesh dhe 480,000 ALL në të mira dhe shërbime.

Përfaqësuesi i Bashkisë Diber
Rahim Spahiu



Përfaqësuesi i World Vision Albania:
Eljona Elmazi

